

V E N D I M
Nr.13 datë 9.1.1993

**PËR PAGËN MESATARE MUJORE TË PUNONJËSVE TË NDËRMARRJEVE DHE
INSTITUCIONEVE SHTETËRORE JOBUXHETORE OSE PJESËRISHT JOBUXHETORE**

Në zbatim të ligjit nr.7583, datë 13.7.1992 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës" me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

Paga mesatare mujore për efekt kontrolli, sipas ministrive dhe institucioneve të tjera qëndrore për sistemin e ndërmarrjeve shtetërore e të institucioneve shtetërore jobuxhetore ose pjesërisht jobuxhetore që ato kanë në varësi, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.345, datë 10.8.1992 "Për shpërblimin e punës të punonjësve", do të përdoret edhe për vitin 1993.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet që nga data 1 janar 1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi